

**Terna Energy Trading sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020**  
**me opinionin e auditorit të pavarur**

---

## Përmbajtja

Pasqyrat financiare për periudhën që perfundon më 31 dhjetor 2020:

Raporti i Audituesit të Pavarur .....	i
Pasqyra e Pozicionit Financiar .....	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse .....	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital .....	3
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare .....	4
Shënime të pasqyrave financiare .....	5-12



## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar : Asamblese se ortakeve te shoqerise “ TERNA ENERGY TRADING ” SHPK**

*Adresa :Rruga e Kavajes, Ndertesa nr 223, Hyrja 32 , 1023,Tirane*

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare “ TERNA ENERGY TRADING ” SHPK **Tirane** , të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020 , pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale,, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020 , performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, **në përputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) .**

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombetare të Auditimit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen “Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare”. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare ne Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa . Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.


### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me **Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF)** , dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë .

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Nderkombetare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.





Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

#### Ceshtje të tjera

Përhapja e shpejtë e virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës së raportuar të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Por nga opinionin i drejtimit dhe deklaratat e leshuara prej tyre si dhe deklaratimet në periudhat 2020 deri në datën e leshimit të raportit nuk ka influenza mbi vijimesinë e shoqërisë dhe aktivitetin e saj

Date 30/03/2021

Shoqëria audituese  
“Euro – audit, consultancy. co” shpk  
Auditues ligjor  
Paqesor Qato



**Terna Energy Trading sh.p.k**

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Aktivët:</b>			
<b>Aktivët afatshkurtra:</b>			
Kërkesa ndaj ortakut	7	-	500,000
TVSH e arkëtueshme	7	398,628	287,268
Mjete monetare dhe ekuivalentë	6	1,452,954	4,032,462
		<b>1,851,582</b>	<b>4,819,730</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,851,582</b>	<b>4,819,730</b>
<b>Kapitalet e veta:</b>			
Kapitali aksionar	8	500,000	500,000
Humbja e akumuluar		(5,103,954)	(1,638,700)
Humbja e vitit		(3,306,097)	(3,465,254)
		<b>(7,910,051)</b>	<b>(4,603,954)</b>
<b>Detyrime afatshkurtra:</b>			
Detyrime ndaj personelit	9	113,200	113,200
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	10	425,284	451,028
Detyrime ndaj Terna S.A Dega Shqipëri	11	1,360,700	1,339,470
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>1,899,184</b>	<b>1,903,698</b>
<b>Detyrime afatgjata:</b>			
Huamarrje nga Terna Energy Overseas Limited	12	7,862,449	7,519,986
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>7,862,449</b>	<b>7,519,986</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>9,761,633</b>	<b>9,423,684</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,851,582</b>	<b>4,819,730</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 12, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi i Terna Energy Trading sh.p.k më 15/03/2021.

Dimitrios Milionis  
Administrator



Rezarta Xhakollari  
Financiere

**Terna Energy Trading sh.p.k**

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura	13	-	-
Shpenzime personeli	14	(1,947,264)	(1,947,264)
Shpenzime të tjera operative (qira)	15	(219,294)	(206,352)
Shpenzime konsulence dhe të tjera	15	(551,784)	(912,227)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	15	(157,287)	(162,134)
Shpenzime për komisione bankare	15	(23,986)	(22,833)
Tarifa e licensimit nga ERE	15	-	(40,000)
Tarifë rregullatore për ERE	15	(100,000)	-
<b>Humbja nga aktiviteti operativ</b>		<b>(2,999,615)</b>	<b>(3,290,810)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(2,999,615)</b>	<b>(3,290,810)</b>
Të ardhura financiare	16	66,637	199,471
Shpenzime financiare	16	(373,119)	(373,915)
<b>Fitimi financiar neto</b>		<b>(306,482)</b>	<b>(174,444)</b>
Shpenzim për tatim fitimi		-	-
<b>Humbja neto</b>		<b>(3,306,097)</b>	<b>(3,465,254)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 12, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

**Terna Energy Trading sh.p.k**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

*(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Humbja e akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 01 janar 2019</b>	<b>500,000</b>	<b>(1,638,700)</b>	<b>(1,138,700)</b>
Humbja e vitit		(3,465,254)	<b>(3,465,254)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>500,000</b>	<b>(5,103,954)</b>	<b>(4,603,954)</b>
Humbja e vitit	-	(3,306,097)	<b>(3,306,097)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>500,000</b>	<b>(8,410,051)</b>	<b>(7,910,051)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 12 bashkëlidhur, që janë pjesë e pasqyrave financiare.

<b>Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Humbja pas tatimit</b>	<b>(3,306,097)</b>	<b>(3,465,254)</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	-	-
Vlera neto e aktiveve te shitura	-	-
Të ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime për interesa	-	-
Humbja/(fitim) neto nga shitja aktiveve	-	-
<b>Fitimi/ (humbja) operative nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>(3,306,097)</b>	<b>(3,465,254)</b>
<i>Ndryshime ne kapitalin punues:</i>		
Pakësim/(rritje) në kërkesa për t'u arkëtuar (ndaj ortakut)	500,000	-
Pakësim/ (rritje) në kërkesa të tjera për t'u arkëtuar (TVSH)	(111,360)	(186,228)
Rritje/(Pakësim) në detyrime për t'u paguar ndaj personelit	-	60,000
Rritje/(Pakësim) në detyrime te tjera për t'u paguar	(4,514)	48,183
Rritje (Pakësim) në interesin e pagueshëm	342,463	-
<b>Mjetet monetare të përfuara nga aktivitetet</b>	<b>(2,579,508 )</b>	<b>(3,543,299)</b>
Tatim mbi fitimin i paguar	-	-
Interesi i paguar	-	-
<b>Mjetet monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<b>(2,579,508 )</b>	<b>(3,543,299)</b>
<b>FLUKSI MONETAR NGA VEPRIMTARITË INVESTUESE</b>		
Shitja e aktiveve	-	-
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>FLUKSI MONETAR NGA VEPRIMTARITË FINANCIARE</b>		
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	-	7,519,986
<b>Mjetet monetare neto të përdorur në aktivitetet financiare</b>	<b>-</b>	<b>7,519,986</b>
<b>RRITJA (RËNIA) NETO E MJETEVE MONETARE</b>	<b>(2,579,508)</b>	<b>3,976,687</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4,032,462	55,775
<b>MJETET MONETARE NË FUND TË PERIUDHËS KONTABEL</b>	<b>1,452,954</b>	<b>4,032,462</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 12 bashkëlidhur, që janë pjesë e pasqyrave financiare.



## **Terna Energy Trading sh.p.k**

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

---

### **1. Hyrje**

Terna Energy Trading sh.p.k (“Shoqëria”) është regjistruar si shoqëri në Shqipëri më 26 dhjetor 2017. Aksionari i vetëm është Terna Energy Trading Limited.

Shoqëria është e përfshirë në tregtimin e energjisë dhe sigurimin e shërbimeve ndërmjetësuese për kompanitë e grupit për blerjen e të drejtave të kapacitetit në Shqipëri.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Dimitrios Milionis.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr. 223, Hyrja 32, 1023, Njësia Administrative Nr. 7. Numri i punonjësve në fund të vitit 2020 është 2 (2019: 2).

### **2. Përmbledhje e politikave kontabël**

Ky shënim përmban një listë të politikave të rëndësishme të kontabilitetit të ndjekura gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare për të cilat nuk është dhënë informacion në shënimet shpjeguese të tjera. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha vitet e raportuara, nëse nuk përcaktohet ndryshe.

#### **Baza e përgatitjes**

*Pajtueshmëria me SNRF*

Në përputhje me Ligjin Nr. 25, datë 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

*Baza e matjes*

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, nëse nuk specifikohet ndryshe.

#### **2.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

*Monedha funksionale dhe raportuese*

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

*Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit prej këtyre transaksioneve, si dhe efekti i përkthimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj njihen përgjithësisht si fitim ose humbje.

Më poshtë paraqiten kurset e rëndësishme të këmbimit në Lekë të zbatuar gjatë vitit dhe në datën e raportimit:

	<b>Kursi mesatar</b>	<b>Kursi raportimit</b>	<b>Kursi mesatar</b>	<b>Kursi raportimit</b>
	<b>2020</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>	<b>2019</b>
Lekë / Euro	123.77	123.7	123	121.77

## **2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

### **2.2 Instrumentet financiarë**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale mbi instrumentin.

#### *Aktive financiare*

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohej më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Klasifikimi dhe matja e mëpasshme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

Aktivitetet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer çdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paafësi paguese dhe falimentim.

Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

#### *Detyrimet financiare*

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra në letra me vlerë), shumat e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

### **2.3 Zhvlerësimi**

Një aktiv testohet për zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivitetit.

Një humbje zhvlerësimi në lidhje me aktivin llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës së rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot për shitje ose vlera në përdorim e një aktivi, cilado qoftë më e lartë.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim.

### **2.4 Kapitali**

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

### **2.5 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë në banka dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi baza konstatimi duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi llogaritë në banka. Shpenzimet nga interesi njihen në fitime ose humbje me metodën e interesit efektiv.

## **2.6 Përfitimet e punonjësve**

### *Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë Shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond të veçantë të manaxhuar nga qeveria. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

## **2.7 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe për të cilin do të kërkohen flukse dalëse parash për shlyerje. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

Provizionet rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe rregullohen për të pasqyruar çmuarjen më të mirë aktuale. Nëse nuk është më e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike të kërkohet për të shlyer një detyrim, atëherë provizioni rimerret.

## **2.8 Qiratë**

*SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)*, përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka ndjekur përjashtimet e lejuara nga Standardi lidhur me qiratë afatshkurta dhe qiratë me vlerë të ulët. Qiraja e Shoqërisë për zyrat është konsideruar nga drejtimi si qira me vlerë të ulët dhe për pasojë zbatimi i SNRF 16 nuk ka patur impakt tek Shoqëria.

## **2.9 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara**

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2020, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

- Ndryshime ne Kuadrin Konceptual per Raportimin Financiar (publikuar ne 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime ne SNRF 3 "Perkufizimi i nje biznesi" (publikuar ne 22 tetor 2018 dhe efektive per blerjet e bera për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020)
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

## **2.10 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara**

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

Ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- Shitja ose kontributi i Aktiveve mes një Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar në Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata- Amendimi në SNK 1 (publikuar më 23 Janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

## **3. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin, vlerësimin dhe supozime që ndikojnë procesin e zbatimit të politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojnë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar, si edhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

### **3.1 Parimi i vijimësisë**

Ekzistenca e Koronavirusit të ri (Covid-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe tashmë është përhapur përtej kufijve të Kinës duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi. Më tej, më 12 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e COVID-19 pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet shqiptare zbatuan masa të shumta duke u përpjekur të përmbajnë përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantinat, urdhrat e strehimit dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, duke përfshirë edhe mbylljet. Këto masa, ndër të tjera, kanë kufizuar rëndë veprimtarinë ekonomike në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht dhe mund të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në bizneset, si dhe ekonominë shqiptare dhe globale për një periudhë të panjohur kohore.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, meqenëse drejtuesit e Shoqërisë besojnë se Shoqëria do të vijojë të paktën aktivitetet e saj administrative dhe gjyqësore edhe gjatë vitit pasardhës.

## **4. Përcaktimi i vlerave të drejta**

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, çka nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të cilët nuk janë të tregtueshëm në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikën e vlerësimit.

(a) *Aktivete financiare të mbajtura me kosto të amortizuara*

Vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afatshkurtra.

(b) *Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuara*

Vlera e drejtë e llogarive të pagueshme dhe huasë afatshkurtra supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afatshkurtra.

## Terna Energy Trading sh.p.k

Shënime të pasqyrave financiare për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

### 5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit nga rreziqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut dhe mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shënime të tilla sasiore janë të përfshira gjatë gjithë pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë për hartimin e procedurave për manaxhimin e rreziqeve të Shoqërisë.

Politikat e manaxhimit të rrezikut janë krijuar nga Shoqëria për të analizuar dhe identifikuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballet dhe për të përcaktuar metodat e kontrollit dhe caktimin e limiteve sipas të cilave do të monitorohen treguesit e rreziqeve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rreziqeve janë riparë rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe të aktiviteteve të Shoqërisë.

Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare në bankë, llogari të arkëtueshme, llogari të pagueshme, hua afatshkurtër dhe detyrime të tjera.

#### (i) Rreziku i kreditimit

Ekziston një rrezik kreditimi në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura, për të cilat nuk është regjistruar zhvlerësim, të një cilësie të kënaqshme.

#### (ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në kohën e maturimit të tyre. Përjasja e Shoqërisë është të sigurojë sa më tepër likuiditete të jetë e mundur që të ketë kurdoherë fonde të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e saj brenda afateve normale apo të forcuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme apo rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

### 6. Mjete monetare

Aktivitet afatshkurtra:	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Në Lekë	206,913	449,667
Në Euro	1,246,041	3,582,795
<b>Totali i Mjeteve monetare</b>	<b>1,452,954</b>	<b>4,032,462</b>

Shoqëria ka dy llogari bankare, në Lekë dhe në Euro, të hapura pranë bankës Raiffeisen Bank.

### 7. Kërkesa të arkëtueshme

Aktivitet afatshkurtra:	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kërkesa ndaj ortakut	-	500,000
TVSH e arkëtueshme	398,628	287,268
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>398,628</b>	<b>787,268</b>

### 8. Kapitali aksionar

Shoqëria është në pronësi të Terna Energy Trading Limited. Kuota ka një vlerë nominale prej 500,000 Lekë. Kontributet në kapital janë detajuar në vijim:

	Data e vendimit të pronarit	Numri i kuotave	Vlera nominale në Lekë
Kapitali fillestar	26 dhjetor 2017	1	500,000
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>		<b>1</b>	<b>500,000</b>

**Terna Energy Trading sh.p.k**

Shënime të pasqyrave financiare për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

**9. Detyrime ndaj personelit dhe të tjera**

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Detyrime ndaj personelit	113,200	113,200
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>113,200</b>	<b>113,200</b>

**10. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera**

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Pricewaterhouse Coopers Audit shpk	29,688	58,450
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	38,795	38,795
Tatim mbi të ardhurat personale	10,277	10,277
Tatimi në burim	42,131	40,413
Të tjera	304,393	303,093
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>425,284</b>	<b>451,028</b>

**11. Detyrime ndaj Terna S.A Dega Shqipëri**

<b>Detyrime afatshkurtra:</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Detyrime ndaj Terna S.A Dega Shqipëri	1,360,700	1,339,470
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>1,360,700</b>	<b>1,339,470</b>

**12. Hua afatgjatë**

Shoqëria gjatë vitit 2019 ka marrë një hua nga Terna Energy Overseas Limited. Kjo hua është njohur si detyrim afatgjatë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Huamarrje nga Terna Energy Overseas Limited	7,862,449	7,519,986
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>7,862,449</b>	<b>7,519,986</b>

**13. Të ardhura**

Shoqëria nuk ka kryer asnjë aktivitet ekonomik gjatë vitit 2020 dhe si rrjedhojë nuk ka realizuar asnjë të ardhur.

**14. Shpenzime personeli**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzime page	1,668,607	1,668,607
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	278,657	278,657
	<b>1,947,264</b>	<b>1,947,264</b>

Shoqëria ka një administrator dhe kompensimi gjatë vitit 2020 - ka qenë 910,814 Lekë, dhe përbëhet nga shpenzimet e pagës dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (2019: 910,814 Lekë).

**Terna Energy Trading sh.p.k**

Shënimet e pasqyrave financiare për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

**15. Shpenzime të tjera operative**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzime qiraje për zyrat e shoqërisë	219,294	206,352
Shpenzime ligjore dhe noteriale	900	508,575
Shpenzime për shërbime financiare	550,884	403,652
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	157,287	162,134
Shpenzime për komisione bankare	23,986	22,833
Tarifa e licensimit nga ERE	-	40,000
Tarifë rregullatore për ERE	100,000	-
	<b>1,052,351</b>	<b>1,343,546</b>

**16. Fitime/Humbje nga këmbimet valutore**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Të ardhura financiare	66,637	199,471
Shpenzime financiare	(373,119)	(373,915)
	<b>(306,482)</b>	<b>(174,444)</b>

Shpenzimet financiare përbehen nga shpenzimet e interesit në vlerën 223,275 Lekë (2019: 213,786 Lekë), si edhe humbje nga përkthimet valutore në vlerën 149,844 Lekë (2019: 160,129 Lekë).

**17. Humbje (Fitimi) i vitit**

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, norma e aplikueshme për tatim fitimin për vitin 2020 është 5% (2019:5%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi nuk janë përfundimtare deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Fitimi për vitin	(3,306,097)	(3,465,254)
Shpenzime të pazbritshme	262,745	37,868
Humbje fiskale	(3,043,352)	(3,427,386)
<b>Total</b>	<b>(3,043,352)</b>	<b>(3,427,386)</b>

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 Shoqëria ka rezultuar me humbje fiskale prej 3,043,352 Lekë.

**18. Palët e lidhura**

Në datën e raportimit, balancat e mëposhtme i korrespondojnë transaksioneve me palët e lidhura:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Huamarrje nga Terna Energy Overseas Limited	7,422,000	7,306,200
Interesa të pagueshëm	440,449	213,786
<b>Totali</b>	<b>7,862,449</b>	<b>7,519,986</b>

Shpenzimet e interesit përgjatë vitit 2020 janë në shumën 223,275 (2019: 213,786) Lekë dhe paraqiten në shënimin 16, nën zërin shpenzime financiare.

**19. Ngjarje pas datës së raportimit**

Ndërsa pandemia e Covid-19 vazhdon, qeveria shqiptare po zbaton masa shtesë për të adresuar çështjet aktuale të shëndetit publik dhe ndikimin në ekonomi. Shoqëria ka vlerësuar se një ngjarje e tillë që vazhdon të ekzistojë, nuk kërkon ndonjë rregullim dhe rishikim tjetër të informacionit të raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2020.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.